



Data: 29/07/2019

Ref.: 18551/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji “UBT” në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022 me kampusin kryesorë në Prishtinë
- II. Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit “UBT” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
  - Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS, në kampusin Prizren dhe Ferizaj, maksimumi 100 studentë për vit akademik për secilin kampus;
  - Inxhinieria e Agrikultures dhe Mjedisit BSc, 180 ECTS, me specializim në: 1. Prodhimtari Bimore, 2. Agrobiznes, maksimumi 100 studentë për vit akademik;
  - Shkencat dhe Teknologjia e Ushqimit, MSc, 120 ECTS, me specializim në 1. Ushqim dhe agroinxhinieri, 2. Menaxhim me cilësinë dhe sigurinë ushqimore, 3. Të ushqyerit (nutricioni), maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  - Teknik i Anesteziologjisë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
  - Teknik i Radiologjisë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
  - Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi, BA, 180 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
  - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BSc, 180 ECTS, kampusi Ferizaj, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  - Arte dhe Media Digjitale, BSc, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  - E Drejta Civile dhe e Pronës, LLM, 60 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  - Stomatologji, Dr. Dent. 360 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;



- III. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit "UBT" për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2024:
- Farmaci, MPH, 300 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- IV. Nuk akreditohen programet e studimit:
- Shkenca Politike, MA, 120 ECTS
  - E Drejta Penale, LL.M, 60 ECTS
  - Teknik i Stomatologjisë, BSc, 180 ECTS
- V. Obligohet Kolegji UBT që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

I. Kolegji UBT ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar tri vizita të ndara me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit. Vizita e parë është realizuar me 20.05.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik, Marina Novak dhe Magdalena Platis, vizita e dytë është realizuar me datë 31.05.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Oana Sarbu, Alan Brichood, Peter Parycek, Zdravko Lackovic dhe Ulrike Beier, ndërsa vizita e tretë është realizuar me datë 14.04.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Balint Bachman, Joachim Mueller, Reiner Doluschitz dhe Stephen Adam.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit UBT dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të tri vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji UBT përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji UBT i plotëson plotësisht tre (3) prej tyre, përkatësisht: Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit, ndërsa plotëson substancialisht 8 (tetë) të tjera, përkatësisht Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Menaxhimi i Cilësisë; Mësimdhënia dhe Mësimarrja;



Hulumtimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe Hapësirat; Bashkëpunimi institucional).

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitivin II dhe III të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se këto programe përmbushin substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e akreditimit.

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitivin IV të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se këto programe përmbushin pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht nuk kanë rekomanduar akreditimin e tyre. Për programin e studimit Shkenca Politikë, MA, eksperti ndërkombëtarë ka konstatuar kryesisht këto mangësi në raport me standardet e akreditimit që kanë qar në rekomandimin negativ për akreditim: sa i përket misionit të programit të studimit, sipas ekspertit, fillimisht kanë munguar disa dokumente të cilat kanë penguar procesin e akreditimit për këtë program të studimit për të kuptuar përshtatshmërinë e nivelit dhe natyrës së lëndëve të programit të propozuar. Sipas ekspertit institucioni nuk ka bërë ndonjë hulumtim të tregut për programin e propozuar, po ashtu ka pasur paqartësi sa i përket titullit të programit të studimit dhe profileve të cilat studentët mund ti zgjedhin gjatë studimeve të tyre. Sipas ekspertit institucioni nuk ka hartuar rezultate të të nxënës për secilin profil dhe se pavarësisht ekzistimit të disa qëllimeve të arsyeshme të programit, të njëjtat nuk janë shprehur në rezultate të qarta të të nxënës.

Sa i përket menaxhimit të cilësisë, eksperti ka konstatuar institucioni nuk e përmbush këtë standard. Sipas tij, institucioni ka një qasje komplekse ndaj menaxhimit të cilësisë dhe se gjatë takimit me përfaqësuesit e sigurimit të cilësisë është kuptuar që këta përfaqësues ishin përfshirë në programin e studimit mirëpo nuk kishin asnjë rol në refuzimin e propozimit para se ai të aprovohej nga institucioni. Sipas ekspertit është e qartë që sistemet e sigurimit të cilësisë nuk kanë ndonjë fuqi formale për të rishikuar propozimet e reja dhe se roli i tyre është administrativ, mbledhje të të dhënave dhe analiza dhe se nuk ka ndonjë rol të gjyqimit apo vlerësimit të programit. Për më tepër shumë çështje kanë mbetur pa u përgjigjur dhe se mungesa e rezultateve të të nxënës në nivel të përgjithshëm të programit ishte shembulli i një sistemi të dobët.

Sa i përket stafit akademik, eksperti ka konstatuar se ekziston një numër i kualifikuar i stafit akademik megjithatë është e cuditshme që një anëtar i stafit të ketë numër të madh të lëndëve. Për më tepër, sipas ekspertit, mbetet e paqartë se sa prej stafit akademik janë parashikuar që të jenë përgjegjës edhe për lëndët e shkencave Politike në nivelin Bachelor. Për kapitullin e përmbajtjes së procesit mësimor, eksperti ka konstatuar se programi i studimit nuk përmbush këtë standard sipas Manualit të AKA-së. Ani pse programi ka disa qëllime të përshtatshme ato nuk kanë përkthyer qartë në rezultate të të nxënës. Sa i përket përmbajtjes eksperti ka konstatuar se programi i studimit aktualisht nuk përputhet me nevojat e deklaruara të institucionit në kuptimin linguistik, struktural dhe në zhvillimin e aftësive praktike. Sipas ekspertit disa prej çështjeve të cilat duhet të konsiderohen tutje janë: përshkrimet e lëndëve nuk i kanë të



përcaktuar stafin akademik, nuk ka arsyeshmëri për numrin e madh të lëndëve zgjedhore, përshkrimet e lëndëve nuk janë uniforme sa i përket natyrës dhe nivelit të përmbajtjes së tyre, shumë pak lëndë specifikojnë artikuj shkencore të cilat janë esenciale për një nivel master të studimit, nuk ka përshkrim të lëndës për lëndën e temës së diplomës e cila ka rëndësi kritike, nuk ka përshkrim të përshtatshëm të lëndës për pjesën praktike të programit, shumica e lëndëve kanë elemente të ndryshme të vlerësimit, nuk ka arsyeshmëri për vlerësimin e përgjithshëm të programit të studimit, etj.

Sa i përket programit të studimit Juridik Penal, LLM, eksperti ndërkombëtarë i akreditimit ka numëruar këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në dhënien e rekomandimit negativ për akreditim. Sipas ekspertit problemet kryesore për këtë program të studimit është standardi për stafin akademik dhe hulumtimin të cilin institucioni nuk i përmbush sipas Manualit të Akreditimit. Nga lista e stafit të prezantuar nga institucioni eksperti ka konstatuar se duke u bazuar në CV-të e tyre stafi nuk është i përshtatshëm për të ofruar një program master të studimit në fushën e penale juridike. Gjithë stafi akademik kanë përvojë në fusha të tjera dhe kanë profile cilësore mirëpo shumica e tyre nuk kanë përvojë fare në fushën e juridikut penal dhe lëndëve përkatëse. Sipas ekspertit ky element nuk është i përshtatshëm sepse ekspertiza e kandidatëve nuk duhet të gjenerohet përmes mësimdhënies mirëpo edhe përmes hulumtimit.

Sa i përket kapitullit të Hulumtimit, eksperti ka konstatuar se përshkrimi i raportit të vet vlerësimit të institucionit është shumë i përgjithshëm dhe nuk ka ndonjë pikë reference për hulumtimin në fushën e juridikut. Fakultetit Juridik nuk ka përcaktuar objektiva dhe as ndonjë plan të zhvillimit të hulumtimit. Sipas ekspertit përgjithësisht programi master ofron mundësinë që të kombinohet hulumtimi dhe mësimdhënia mirëpo prandaj duhet të hartohen objektiva dhe koncepte të qartë për punën kërkimore. As në RVV dhe as gjatë diskutimit gjatë vizitës të akreditimit nuk janë ofruar këto elemente. Përfundimisht eksperti ka konstatuar se institucioni për këtë program të studimit nuk përmbush standardin e Hulumtimit sipas Manualit të Akreditimit të AKA-së.

Sa i përket programit të studimit Teknik i Stomatologjisë, BSc, eksperti ndërkombëtarë i akreditimit ka deklaruar ky program përmbush pjesërisht standardet e Manualit të Akreditimit të AKA-së. Sipas ekspertit misioni, objektivat dhe administrimi i programit Teknik i Stomatologjisë është pothuajse identik me misionin dhe objektivat e programit të studimit të integruar të Stomatologjisë. Eksperti ka deklaruar se vëren që në këtë kapitull është bërë një kopjim sa i përket misionit dhe nuk është punuar që ky program individualisht të ketë mision dhe objektiva të tij.

Sa i përket stafit akademik, eksperti ka deklaruar se ngarkesa e profesorëve të paraqitur për këtë program të studimit nuk është e qartë dhe nuk lejon vlerësim objektiv. Për më tepër gjatë vizitës është kuptuar që stafi i këtij programi të studimit është i angazhuar edhe në programe të tjera dhe se aryeja se pse është paraqitur në formë të përqindjes ngarkesa e profesorëve, është për të fshehur ngarkesën e vërtetë të stafit akademik për këtë program të studimit. Duke qenë se stafi për programin e studimit Teknik i Stomatologjisë duhet të jetë i rregullt vetëm për këtë program të studimit eksperti ka deklaruar që programi nuk mund të akreditohet në këtë formë.

Sa i përket përmbajtjes së procesit mësimor, eksperti ka deklaruar se RVV përmban paqartësi sa i përket kohëzgjatjes së programit dhe se emrat të ndryshëm janë përdorë për programin e studimit meqenëse


duket se programi është kopjuar nga programi i integruar i Stomatologjisë. Sipas ekspertit, kërkesat minimale që studenti duhet ti përmbush përgjatë studimeve të tyre nuk përkojnë aspak me programin e studimit, dhe se plan programi nuk është i fokusuar që studentët të bëhen Teknik të Stomatologjisë prandaj nuk i përmbush stabdardet e akreditimit.

Sa i përket kapitullit të Hulumtimit, eksperti ka deklaruar që plani i hulumtimit për këtë program është identik me planin e hulumtimit të programit në Stomatologji prandaj eksperti rekomandion që të hartohet një plan hulumtimi vetëm për programin e studimit Teknik i Stomatologjisë dhe të motivohet stafi akademik që të rrisin prodhimin shkencor duke marrë parasysh reuzultatet e hulumtimit në procesin e avancimit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji UBT
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë